

Termet e Referencës

Ekspert/e për fasilitimin e fokus grupit me OSHC-të mbi mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për shkeljet e të drejtave të fëmijëve

I. HYRJE

HANDIKOS, "Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës" është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin "Handikos for Child Rights-H4CR", i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një fasilitator/e për të udhëhequr një diskutim një-ditor me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre për mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e të dhënave mbi shkeljet e të drejtave të fëmijëve, përfshirë rastet e abuzimit seksual, fizik dhe emocional.

Ky aktivitet synon të:

- Rrisë kuptueshmërinë e OSHC-ve për rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të besueshme dhe të strukturuar për shkeljet e të drejtave të fëmijëve;
- Diskutojë burimet potenciale të të dhënave, veçanërisht institucionet publike (shkollat, qendrat për punë sociale, policia, etj.), dhe mënyrat për të siguruar qasje në këto të dhëna në përputhje me ligjin dhe standardet etike;
- Ofrojë udhëzime për analizimin e të dhënave, për të identifikuar modele, boshllëqe dhe raste të përsëritura të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve;
- Të ofrojë udhëzime mbi parimet etike dhe praktikën mbrojtëse gjatë mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave për rastet e abuzimit seksual, fizik dhe emocional të fëmijëve, për të siguruar që procesi nuk shkakton dëm të mëtejshëm dhe respekton dinjitetin e viktimave;
- Nxisë shkëmbimin e praktikave dhe përvojave ndërmjet OSHC-ve lidhur me monitorimin dhe dokumentimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve;
- Përgatis një raport pune të të gjeturave kryesore gjatë takimit.

IV. KUALIFIKIMI

- Diplomë universitare në shkenca sociale, zhvillim organizativ ose fusha të ngjashme;
- Njohuri dhe ndjeshmëri për çështjet e të drejtave të fëmijëve me theks të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara ;
- Aftësi të mira analitike, fasilitimi dhe dokumentimi;
- Përvojë të mëparshme për detyra të ngjashme.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Fasilitatori/ja i/e angazhuar do të jetë përgjegjës/e për planifikimin, zbatimin dhe dokumentimin e të gjithë procesit të diskutimit, duke përfshirë:

- Hartimi i një plani të detajuar të punës, përfshirë objektivat e sesionit, metodologjinë, formatin e diskutimit dhe agjendën e ditës;
- Përgatitja e materialeve për lehtësimin e diskutimit, përfshirë pyetje udhëzuese, fletë pune, prezantime vizuale ose mjete të tjera që ndihmojnë pjesëmarrësit të reflektojnë dhe ndajnë përvoja konkrete;
- Konsultimi paraprak me ekipin e HANDIKOS;
- Lehtësimi i diskutimit një-ditor me OSHC-të pjesëmarrëse, me fokus në:
 - Identifikimin e burimeve të të dhënave për shkeljet e të drejtave të fëmijëve;
 - Analizimin dhe strukturimin e të dhënave për përdorim në avokim;
 - Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave efektive;
 - Përgatitjen e rekomandimeve për përdorimin më efikas të të dhënave në ndikimin mbi politikat dhe përgjegjshmërinë institucionale;
- Hartimi i një raporti përfundimtar, i cili duhet të përfshijë:
 - Përmbledhje të procesit të diskutimit dhe pjesëmarrjes;
 - Analizë e çështjeve të ngritura dhe njohurive të ndara gjatë sesionit;
 - Rekomandime të qarta për fuqizimin e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave nga OSHC-të.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Qershor 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Parapërgatitja e fokus grupit dhe materialeve	1 ditë
Fasilitimi i fokus grupit	1 ditë

Përgatitja e raportit	1 ditë
Totali i ditëve	3 ditë

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të leshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit dhe dorëzimit të raportit të punës final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim dhe hartimin e planit të punës (max. 3 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org cc: nora.simitciu@handi-kos.org dhe antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Ekspert për fasilitimin e fokus-grupit me OSHC-të mbi mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për shkeljet e të drejtave të fëmijëve

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 15 Qershor 2025, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetim.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.